



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

**Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë**

Tiranë, 29.06.2016

**Lënda:** Paraqitja e projektligjit “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve në Luftën Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar” dhe procesi për shqyrtimin e tij nga Kuvendi

**Drejtuar :**

**z.Illir META**  
**Kryetar i Kuvendit**

**Në vëmendje :**

Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit

I nderuar z. Kryetar,

Kuvendi, në zbatim të nenit 77 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 24 të Rregullores së tij, me vendimin nr.96/2014 ka vendosur ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë.

Komisioni i Posaçëm, ndër të tjera, ka për objekt të veprimtarisë së tij edhe: (iii) Propozimin për miratim të një pakete të plotë projektligjesh të nevojshme për reformimin e legjislationit, që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë ato kushtetuese, e hartuar me kontributin dhe mbështetjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, subjekteve të tjera të interesuara dhe opinionit publik. (pika 2 e vendimit).

Për realizimin e detyrave të përcaktuara, pranë komisionit të posaçëm parlamentar, është ngritur dhe ka funksionuar Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), i cili asistohet nga sekretariati teknik, detyra e të cilëve ndër të tjera ka qenë ajo për hartimin e projektligjeve të reformës në drejtësi. (pikat 7 e 8 të vendimit).

<b>KUVENDI</b>		
Shenimi i Kryetarit _____		
Futja ne program Shqyrtimi ne seance _____		dt. _____ sh. _____ dt. _____

Në përputhje me vendimin nr.96/2014 dhe vendimmarrjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, Grupi i ekspertëve të Nivelit të Lartë, vendas e ndërkombëtarë, ka hartuar projektligjin “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucioneve në Luftën Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”.

Projektligji, siç edhe është bërë e njohur publikisht përmes medias, i është nënshtruar një procesi të gjerë konsultimesh me ekspertë të fushës, me institucionet përkatëse të sistemit të drejtësisë, me grupet e interesit dhe përfaqësues të shoqërisë civile si dhe është bërë publik përmes faqes së internetit të reformës në drejtësi.

Në përfundim të të gjithë këtij procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, projektligji është dorëzuar/depozituar në fillim të muajit qershor në Komisionin e posaçëm parlamentar i cili e ka përfshirë në kalendarin e punës së tij për shqyrtim në parim, nen për nen dhe në tërësi (vendimi nr.20, datë 14.06.2016).

Ky komision në mbledhjen e tij të datës 20 qershor është njohur me përmbajtjen e projektligjit.

Komisioni ka caktuar relatorin për projektligjin dhe në mbledhjen e datës 6 korrik do të fillojë shqyrtimin në parim dhe nen për nen të tij, sipas kalendarit të punimeve të komisionit.

Në përfundim të këtij procesi, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë (nenet 24, 29, 38, 39, 41, 68, 69 dhe 70) dhe në zbatim të detyrës së ngarkuar nga Vendimi nr.96/2014 të Kuvendit të Shqipërisë, do ta paraqesë projektligjin për shqyrtim e miratim në seancën plenare të përcaktuar në kalendarin e punës së Kuvendit.

Bashkëngjitur do të gjeni një kopje të këtij projektligji së bashku me relacionin përkatës.

Me respekt

**Fatmir XHAFAJ**

Deputet



Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

## **PROJEKTLIGJ**

### **PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

#### **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **VENDOSI:**

#### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

##### **Objekti i ligjit**

Objekti i këtij ligji është:

1. përcaktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme dhe njësisë së pavarur hetimore, të krijuara nga neni 148<sup>1</sup>, paragrafi 3 i Kushtetutës;
2. kushtet shtesë që duhet të përmbushin prokurorët për t'u emëruar në Prokurorinë e Posaçme;
3. kushtet që duhet të përmbushin shtetasit për të qenë oficerë dhe punonjës në njësinë e pavarur hetimore të paragrafit 1;
4. kushtet që duhet të përmbushin shtetasit për të qenë punonjës në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe në Prokurorinë e Posaçme;
5. kompetenca e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe e Prokurorisë së Posaçme;
6. marrëdhëniet e Prokurorisë së Posaçme me institucione të tjera shtetërore, subjekte të tjera publike apo private, si dhe me publikun;
7. organizimi dhe funksionimi për përmbushjen e procesit<sup>2</sup> të hetimit të sigurisë të së kaluarës, vëzhgimit të të dhënave financiare dhe vëzhgimit të telekomunikacioneve të gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar verifikimit, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendës drejtorit dhe shërbimeve të policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit;
8. pajisjen me fonde për punën e Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.

---

<sup>1</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë

<sup>2</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë

## Neni 2

### Qëllimi i Prokurorisë së Posaçme

Qëllimi i Prokurorisë së Posaçme është pasja e një prokurorie të përgjegjshme dhe të specializuar për të hetuar dhe ndjekur penalisht në mënyrë efikase çështjet e vështira të korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe krimet e kryera nga një kategori e caktuar zyrtarësh dhe ish zyrtarësh, në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim i brendshëm dhe i jashtëm<sup>3</sup> i papërshtatshëm.

## Neni 3

### Qëllimi i njësisë së pavarur hetimore

Qëllimi i njësisë së pavarur hetimore është të sigurojë<sup>4</sup> dhe të ofrojë hetues të përgjegjshëm, të pavarur<sup>5</sup> dhe të specializuar për të kryer hetime efikase të çështjeve të vështira të korrupsionit dhe krimit të organizuar për prokurorinë e specializuar, si dhe krimet e kryera nga një kategori e caktuar zyrtarësh dhe ish zyrtarësh, në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim i brendshëm dhe i jashtëm<sup>6</sup> i papërshtatshëm.

## Neni 4

### Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Termi “Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” përdoret për t’iu referuar Prokurorisë së Posaçme dhe njësisë së pavarur hetimore, e cila do të quhet “Byroja Kombëtare e Hetimit”.

## Neni 5

### Prokuroria e Posaçme

1. Prokuroria e Posaçme kryen ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe Gjykatës së Lartë, merr masa dhe mbikqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara me ligj.
2. Prokuroria e Posaçme i kryen funksionet e saj në mënyrë të pavarur, vetëm nëpërmjet atyre prokurorëve që janë emëruar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në përputhje me këtë ligj.

## Neni 6

### Byroja Kombëtare e Hetimit

Byroja Kombëtare e Hetimit është një seksion i specializuar i policisë gjyqësore, që heton veprat penale në juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme. Byroja ka në përbërje të saj Shërbimet e Policisë Gjyqësore sipas ligjit. Byroja Kombëtare e

<sup>3</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë

<sup>4</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë

<sup>5</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë

<sup>6</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë

Hetimit dhe Shërbimet e Policisë Gjyqësore mbikëqyren dhe veprojnë vetëm nën drejtimin e prokurorëve specialë të Prokurorisë së Posaçme.

## **Neni 7**

### **Juridiksioni kombëtar**

Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar e kanë vendndodhjen në Tiranë dhe i ushtrojnë kompetencat e tyre në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu, Byroja Kombëtare e Hetimit mund të krijojë zyra të përkohshme apo të përhershme jashtë Tiranës, për të përmbushur qëllimin e saj.

## **Neni 8**

### **Kushtet e sigurisë para caktimit në detyrë apo emërimit**

1. Kandidatët për gjyqtarë në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, dhe për drejtor e hetues në Byroën Kombëtare të Hetimit duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme të sigurisë, përpara se të caktohen ose punësohen në këto pozicione. Asnjë kandidat nuk mund të caktohet në detyrë ose të punësohet pa plotësuar këto kushte. Të njëjtat kushte duhet të plotësohen edhe nga çdo punonjë tjetër i Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit të cilët kryejnë funksione hetimore ose funksionet e të cilëve mbështesin drejtpërsëdrejti hetimin.<sup>7</sup>
2. Kandidatët plotësojnë dhe dorëzojnë deklaratat për pasurinë dhe konfliktet e interesave tek Inspektoriati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Brenda katër muajve, Kryeinspektori kontrollon deklaratat dhe i paraqet një raport dhe një opinion autoritetit që i cakton në detyrë apo merr në punë, lidhur me faktin nëse deklaratat janë të plota dhe nëse kandidati ka pasuri që janë të padeklaruara apo të pajustificuara nga të ardhurat e ligjshme. Nëse, gjatë 6 muajve para se të paraqiste kërkesën, kandidati ka kaluar një kontroll që nuk ka rezultuar në disfavor të tij, atëherë ky kriter do të konsiderohet si i përmbushur.
3. Kandidatët plotësojnë dhe dorëzojnë në Autoritetin e Sigurisë Kombëtare një pyetësor sigurie, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Brenda 90 ditëve, drejtori i Autoritetit të Sigurisë Kombëtare i paraqet një raport autoritetit që i cakton në detyrë apo merr në punë, lidhur me faktin nëse pyetësori ishte plotësuar në mënyrë të saktë si dhe i tregon çdo shqetësim që mund të burojë nga hetimi i verifikimit të figurës.
4. Kandidatët plotësojnë një deklaratë me shkrim, të nënshkruar nga kandidati dhe anëtarët e afërt të familjes, sipas së cilës, nëse caktohen në detyrë apo merren në punë, telekomunikimet e kandidatit do të jenë objekt vëzhgimi dhe heqin dorë nga e drejta e jetës private lidhur me këto komunikime.

---

<sup>7</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë

## **Neni 9**

### **Përkufizimet**

Termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme në lidhje me këtë ligj:

1. “Gjyqtar” nënkupton, për qëllimet e juridiksionit të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çdo person që shërben si gjyqtar në çdo gjykatë të shkallës së parë, gjykatë apeli, gjykatë administrative, Gjykatën e Lartë, Gjykatën e Lartë Administrative ose anëtar i Gjykatës Kushtetuese.
2. “Prokuror” nënkupton, për qëllimet e juridiksionit të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, çdo prokuror në shkallë të parë, apel, Prokurorinë e Posaçme dhe Prokurorin e Përgjithshëm.
3. “Anëtar i afërt i familjes” nënkupton bashkëshortin/bashkëshorten, fëmijët mbi 18 vjeç dhe çdo person të lidhur nga gjaku apo martesë, i cili banon më shumë se 60 ditë në vit në të njëjtin vendbanim.
4. Në përputhje me përkufizimin e parashikimit të Nenit 135 të Kushtetutës, “drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura” nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Guvernatorin e Bankës Qendrore të Shqipërisë, Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Drejtorin e Shërbimit Informativ Shtetëror.
5. “Veprat penale të lidhura ngushtë me çështjen apo hetimin” nënkupton çdo shkelje penale që është kryer me qëllim përgatitjen, mbështetjen, mundësimin, fshehjen apo shmangien e zbulimit të një shkeljeje penale që bën pjesë në kompetencën kryesore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Për çdo hetim apo ndjekje penale të çështjes në gjykatë brenda kompetencave të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, ajo vlen edhe për çdo vepër penale që pengon hetimin apo çështjen, kanos dëshmitarët, viktimat, gjyqtarët, prokurorët, hetuesit apo punonjësit, apo shkatërron ose i bën provat të papërdorshme në mënyra të tjera.
6. “Informacion sensitiv” nënkupton dokumentet elektronikë apo fizikë, fotografitë, regjistrimet, të dhënat, emrat ose çdo informacion tjetër me shkrim apo verbal, që merret gjatë apo si rrjedhojë e një hetimi penal në përputhje me këtë ligj. Ky informacion nuk konsiderohet sensitiv pasi të jetë bërë publik në përputhje me ligjin.
7. “Hetuesit” nënkupton punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit të cilët janë përgjegjës për hetimin e veptave penale. Hetuesit gëzojnë statusin e oficerëve të policisë gjyqësore, por kontrollohen nga Prokurorët e Posaçëm. Oficerët e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit nuk gëzojnë titullin “hetues”.
8. “Proces i hapur dhe Transparent” është procesi që përfshin minimalisht:

- a. Aplikimin që qartësisht parashikon minimumin e kualifikimeve për pozicionin dhe numrin e vendeve vakante,
- b. Hapësirën e dukshme të njoftimit të aplikimit në ëbsite-n e institucionit publik për të paktën dy javë përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të aplikimeve,
- c. Hapësirën ku njoftimi specifikon afatit përfundimtar të aplikimit që është jo më pak se dy javë pas datës së publikimit,
- ç. Hapësirën ku njoftimi specifikon informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar për tu dorëzuar bashkë me aplikimin,
- d. Hapësirën ku njoftimi specifikon procedurën për aplikimet dhe se ku duhen dorëzuar aplikimet,
- dh. Hapësirën ku të gjithë aplikantëve u jepet vlerësimi bazuar në meritat e tyre,
- e. Hapësirën që informon rreth një komisioni me përbërje të ndryshme që bën përzgjedhjen dhe rekomandimet, dhe
- ë. Informimin në kohën e duhur të aplikuesve rreth rezultateve të konkursit.<sup>8</sup>

## **KREU II KOMPETENCAT**

### **Neni 10**

#### **Kompetenca parësore**

1. Kompetenca parësore e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar përcaktohet në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale. Kompetenca parësore e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, paragrafi 2, i Kushtetutës.
2. Nëse përcaktohet se, në një hetim apo çështje sipas paragrafit 1, nuk ngrihet akuzë kundër një zyrtari sipas Nenit 135, paragrafi 2 i Kushtetutës, apo kundër një drejtuesi të një institucioni qendror ose të pavarur sipas këtij ligji, apo nëse ai zyrtar publik apo zyrtar i lartë largohet gjatë kohëzgjatjes së hetimit, juridiksioni u mbetet gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
3. Prokuroria e Posaçme është kompetente për hetimin dhe ndjekjen penale në përputhje me këtë paragraf.

---

<sup>8</sup> Reflekton parimet e Nenit 48 të Projekt Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

### **Neni 11** **Kompetenca të tjera**

1. Nëse gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar shqyrtojnë një çështje dhe Prokuroria e Posaçme kryejn një hetim brenda kompetencave të parashikuara në nenin 10, gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme kanë kompetencë për të hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër tjetër penale që ka rëndësi dhe është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale.
2. Nëse Prokuroria e Posaçme kryen një hetim të parashikuar nga neni 10, atëherë ka kompetencë për të kërkuar nga gjyqtarët e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar konfiskimin e aseteve përkatëse, sipas Ligjit për Parandalimin dhe Goditjen Krimit të Organizuar, Trafikimit dhe Korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.
3. Nëse Prokuroria e Posaçme kryen një hetim të parashikuar nga neni 10, atëherë ka kompetencë edhe për të kërkuar zbatimin e masave për mbrojtjen e dëshmitarit, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë juridiksion ekskluziv mbi hetimet, çështjet dhe kërkesat e paraqitura në përputhje me këtë nen.

### **Neni 12** **Juridiksioni kombëtar**

Prokuroria e Posaçme ka kompetencë për hetimin dhe ndjekjen penale të çdo vepre të parashikuar nga nenet 10 dhe 11 në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

## **KREU III** **PROKURORIA E POSAÇME**

### **Neni 13** **Prokuroria e Posaçme**

1. Prokuroria e Posaçme përbëhet nga një drejtues i prokurorisë dhe nga prokurorët të posaçëm.
2. Përveçse kur parashikohet ndryshe, dispozitat e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë zbatohen edhe për organizimin dhe veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme.
3. Prokuroria e Posaçme mbështetet nga departamente, në përputhje me këtë ligj. Hetuesit dhe oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve të Byrosë Kombëtare të Hetimit drejtohen nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.



## Neni 14

### **Prokurorët e posaçëm të Prokurorisë së Posaçme**

1. Prokurorët e posaçëm të Prokurorisë së Posaçme emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Kandidatët për prokurorë të posaçëm në Prokurorinë e Posaçme duhet të përmbushin parakushtet e sigurisë të Nenit 8. Një kandidat nuk mund të caktohet në detyrë në Prokurorinë e Posaçme pa përmbushur parakushtet e sigurisë, kushtet e aftësive profesionale dhe parakushtet shëndetësore<sup>9</sup>. Një kandidat i cili ka marrë një opinion negativ nga Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose nga Autoriteti i Sigurisë Kombëtare nuk mund të caktohet në detyrë në Prokurorinë e Posaçme. Një kandidat i cili ka marrë një opinion negativ nga grupi i ekspertëve të mjeksisë ligjore nuk mund të caktohet në detyrë në Prokurorinë e Posaçme.<sup>10</sup>
3. Prokurorët emërohen në detyrë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për një mandat 9 vjeçar. Mandati pezullohet apo të ndërpritet vetëm nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkon procedim disiplinor kundër prokurorit.
4. Në përfundim të mandatit të prokurorit të posaçëm, Këshilli i Lartë i Prokurorisë e kthen atë në pozicionin e tij/saj të mëparshëm ose në pozicione të lira në zyra të tjera të sistemit të prokurorisë, duke marrë përparësi mbi kandidatët e tjerë.

## Neni 15

### **Pavarësia e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme**

1. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme janë të pavarur nga çdo prokuror tjetër, përfshirë drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme.
2. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nuk mund t'i udhëzojë prokurorët e Prokurorisë së Posaçme për thelbin e hetimit apo themelin e asnjë çështje.
3. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme hetojnë dhe ndjekin penalisht prokurorë të tjerë të Prokurorisë së Posaçme apo gjyqtarë të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nëse ka prova se prokurori apo gjykatësi është i korruptuar, mbështet një organizatë kriminale apo ka kryer një tjetër vepër penale brenda kompetencave të Prokurorisë së Posaçme.
4. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme drejtojnë punonjësit e Prokurorisë së Posaçme dhe atë të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe shërbimet e policisë gjyqësore pranë saj përsa i përket hetimit dhe çështjeve të ndjekura prej tyre.

## Neni 16

### **Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme**

1. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme zgjidhet në përputhje me Nenin 148/dh, paragrafi 3, të Kushtetutës.

<sup>9</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë

<sup>10</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë

2. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ushtron funksionet, detyrat dhe kompetencat e mëposhtme:

- a. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme është drejtuesi administrativ i punonjësve të Prokurorisë së Posaçme. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nuk është drejtues operacional i punonjësve në lidhje me hetimet dhe çështjet e ndjekuar prej tyre;
- b. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme u cakton çështjet prokurorëve të posaçëm bazuar në specializimin e tyre dhe vendos lidhur me juridiksionin respektiv të hetimit midis njësisë së posaçme hetimore dhe njësisë hetimore në Policinë e Shtetit;
- c. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme koordinon punën e njësive që janë në kompetencë të tij më agjensitë e tjera të zbatimit të ligjit, shërbimet e inteligjencës, dhe autoritetet e tjera kompetente.
- ç. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme harton dhe i paraqet Ministrisë së Financave buxhetin për Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit, si dhe për pagat e shërbimeve të oficerëve të policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit;
- d. Çdo datë 1 mars, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme i dorëzon Këshillit të Lartë të Prokurorisë një raport vjetor me shkrim mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme;
- dh. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme thërret mbledhjen e Prokurorisë së Posaçme, kur është e nevojshme;
- e. Pas konsultimit me Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe mbledhjes së prokurorëve të posaçëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të nxjerrë udhëzime të përgjithshme me shkrim për Byronë Kombëtare të Hetimit, të cilat përmirësojnë marrëdhëniet e punës, efikasitetin apo garancitë mes dy strukturave<sup>11</sup>. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të nxjerrë edhe udhëzime të përgjithshme me shkrim në lidhje me procedura administrative brenda Prokurorisë së Posaçme, rregullore të nevojshme për funksionimin efikas të Prokurorisë së Posaçme si dhe të miratojë rregullore të nxjerra nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.
- ë. Në mungesë të tij, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të caktojë një prokuror tjetër të posaçëm në rolin e Drejtuesit të Komanduar të Prokurorisë së Posaçme. Nëse kjo mungesë zgjat më shumë se 45 ditë, ose përsëritet vazhdimisht, Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të konfirmojë atë prokuror të posaçëm si Drejtues të Komanduar të Prokurorisë së Posaçme për një periudhë kohore të specifikuar, si dhe merr në konsideratë nëse mungesa e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme është e justifikuar apo përbën shkelje serioze të disiplinës.

---

<sup>11</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë

### **Neni 17**

#### **Mbledhja i Prokurorisë së Posaçme**

Gjatë një mbledhje të Prokurorisë së Posaçme, prokurorët e posaçëm mund të:

1. miratojnë rregulla të brendshme administrative dhe rregullore të nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme;
2. krijojnë komisione të brendshme sipas nevojës;
3. ngrenë dhe diskutojnë shqetësime në lidhje me çështje administrative,
4. vlerësojnë dhe vendosin për kërkesa sipas nenit 27 të këtij ligji, dhe
5. vlerësojnë çështje të personelit, disiplinës, sigurisë apo çështje të tjera.

### **Neni 18**

#### **Struktura e Prokurorisë së Posaçme**

1. Prokuroria e Posaçme përbëhet nga të paktën dhjetë prokurorë, të mbështetur nga personeli i këtyre seksioneve:
  - a. Kancelari dhe Seksioni i Dokumentacionit;
  - b. Seksioni i Ekspertizës;
  - c. Seksioni i Hetimit Financiar
  - ç. Koordinatori i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Ndërlidhjes për Hetimet e Përbashkëta;
  - d. Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat;
  - dh. Seksioni për Asistencën për Individët me Status të Posaçëm.
2. Të gjithë kandidatët për personel i Prokurorisë së Posaçme do të përmbushin kushtet e sigurisë sipas Nenit 8 dhe Kapitullit VIII të këtij ligji.

### **Neni 19**

#### **Kancelari dhe Seksioni i Dokumentacionit**

1. Prokuroria e Posaçme ka një kancelar, i cili mbikëqyr dosjet, arkivën, shërbimet mbështetëse dhe financat e Prokurorisë. Kancelari përgjigjet para drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.
2. Seksioni i Dokumentacionit:
  - a. mbledh në mënyrë sistematike të dhëna për rastet e korrupsionit dhe krimet të organizuar;
  - b. krijon dhe mban një bazë të dhënash që shërben si burim informacioni në procedimet për vepra penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale;
  - c. kryen detyra të tjera të nevojshme për punën e zyrës.

### **Neni 20**

#### **Seksioni i Ekspertizës**

1. Prokuroria e Posaçme ka ekspertë që ndihmojnë në hetime dhe mund të dëshmojnë në gjyq.

2. Ekspertët duhet të kenë përfunduar minimalisht studimet në nivelin master i shkencave<sup>12</sup> në fushën e tyre të ekspertizës.
3. Ekspertët duhet të kenë të paktën pesë vjet përvojë në fushën e tyre të ekspertizës.
4. Prokuroria e Posaçme ka ekspertë në fusha të ndryshme për ta ndihmuar në ushtrimin e kompetencave të saj. Prokuroria ka të paktën një ekspert kontabël dhe një ekspert të teknologjisë së informacionit.
5. Edhe punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët janë të kualifikuar sipas këtij neni, mund të japin ndihmesën e tyre në hetime apo të dëshmojnë.

## **Neni 21**

### **Seksioni i Hetimit Financiar**

1. Prokuroria e Posaçme ka një seksion të hetimit financiar që verifikon mjetet financiare dhe pasuritë e të pandehurve dhe raporton rezultatet tek Prokurori i Posaçëm kompetent.
2. Punonjësit e këtij seksioni janë të diplomuar në drejtësi, financë, llogaritar, apo në fusha të tjera përkatëse.
3. Punonjësit e seksioneve<sup>13</sup> kanë një eksperiencë minimale pune dy vjeçare si oficerë të policisë gjyqësore.
4. Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët kualifikohen sipas kësaj dispozite, mund të japin asistencë.

## **Neni 22**

### **Ndërlidhësi për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe hetimet e përbashkëta**

1. Prokuroria e Posaçme ka të paktën një punonjës, i cili do të jetë ndërlidhës me organet e huaja në shërbim të ecurisë së hetimeve apo hetimeve të përbashkëta. Ndërlidhësi duhet të ketë minimalisht arsim të lartë në drejtësi dhe një diplomë masteri, nga të cilat njëra duhet të jetë marrë jashtë Shqipërisë. Ndërlidhësi mund të jetë një prokuror i cili atashohet për këtë pozicion. Çdo prokuror i cili atashohet për këtë pozicion do të përmbushë kushtet e sigurië sipas Nenit 8 dhe Kapitullit VIII të këtij ligji.
2. Ndërlidhësi duhet të ketë të paktën pesë vite përvojë në fushën e drejtësisë.
3. Ndërlidhësi duhet të njohë rrjedhshëm gjuhën shqipe dhe atë angleze, si edhe të njohë një gjuhë tjetër të huaj të nevojshme për vendin e punës.

## **Neni 23**

### **Detyrat e ndërlidhësit**

1. Ndërlidhësi:

---

<sup>12</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë

<sup>13</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë

- a. në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, bashkëpunon me autoritete kompetente të shteteve të tjerë dhe organizatave ndërkombëtare;
  - b. cakton anëtarë në organet e përbashkëta hetimore, të krijuara në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare ose në bazë të një marrëveshjeje për një rast konkret, me qëllim hetimin, ndjekjen penale ose përfaqësimin në gjyq të veprave penale të parashikuara nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, në Republikën e Shqipërisë, ose në një ose më shumë shtete të tjerë;
  - c. lidhur me hetimet e përbashkëta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, Departamenti i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Hetimeve të Përbashkëta mbikëqyr zbatimin e rregulloreve të brendshme dhe respektimin e sovranitetit të Republikës së Shqipërisë. Në lidhje me dobësitë e identifikuara dhe çështjet e debatuarra, të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve me organet kompetente të një shteti tjetër ose përfaqësuesit e tij, informon pa vonesë Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, i cili, nëse është e nevojshme, kërkon mendimin ose ndihmën e ministrisë kompetente.
2. Për nevojat e hetimeve të përbashkëta, ndërlihdësi:
- a. merr kërkesat e shteteve të tjerë për të bërë hetime të posaçme për çështje penale, ndërmerr veprimet e nevojshme para gjykatave kompetente dhe ofron ndihmë ligjore në procedime për vepra penale, të parashikuara nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale;
  - b. në rastin e veprimeve veçanërisht urgjente, për kryerjen në mënyrë të pavarur të të cilave brenda territorit të Republikës së Shqipërisë janë të autorizuar organet kompetente të shteteve të tjerë, bazuar në marrëveshje të posaçme, mbikëqyr këtë veprimtari, duke vëzhguar që organi kompetent i shtetit tjetër të mos shkelë paprekshmërinë e banesës ose të drejtës për liri personale e dinjitet të personit. Pas ndërmarrjes së këtyre veprimeve, i dorëzon një raport përfundimtar Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili mund të kërkojë praninë e një nëpunësi të huaj të autorizuar gjatë dorëzimit të raportit.

## **Neni 24**

### **Koordinatori për Marrëdhënien me Mediat**

1. Prokuroria e Posaçme ka një Koordinator për Marrëdhënien me Mediat, i cili kryen ndërlihdhjen mes Prokurorisë dhe mediave kombëtare e ndërkombëtare.
2. Koordinatorin e Marrëdhënies me Mediat është i vetmi person i autorizuar për të folur me mediat në emër të Prokurorisë së Posaçme, në lidhje me hetime apo çështje penale.
3. Koordinatorin e Marrëdhënies me Mediat ka diplomë të një fushe të lidhur me detyrën dhe, të paktën, pesë vite përvojë pune me një organizatë mediatike apo si ndërlihdhës shtypi i një agjencie publike, organizate ndërkombëtare apo ambasade.

4. Koordinator i Marrëdhënieve me Mediat gjithashtu:
  - a. informon publikun për rrezikun dhe dëmet e korrupsionit dhe për metodat dhe instrumentat për parandalimin e tij;
  - b. bazuar në autoritetin dhe udhëzimet e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, informon publikun për punën e zyrës;
  - c. kryen detyra të tjera, bazuar në planin vjetor të punës së zyrës.
5. Punonjësit e marrëdhënieve me mediat njohin rrjedhshëm gjuhët shqipe dhe atë angleze.

## **Neni 25**

### **Seksioni për Asistencën për Individët me Status të Posaçëm**

1. Prokuroria e Posaçme ka një seksion i cili ofron shërbime për individët me status të posaçëm sipas Kodit të Procedurës Penale, përfshi viktimat e krimeve që janë brenda kompetencave të kësaj Prokurorie, si dhe për dëshmitarët në hetimet dhe çështjet e ndjekura nga kjo Prokurori, në përputhje me ligjet përkatëse.
2. Departamenti ka të paktën dy koordinatorë, por do të ketë më shumë në varësi të nevojës nga numri i hetimeve dhe çështjeve.
3. Koordinatorët do të kenë diploma nga një universitet i licencuar, në degët e psikologjisë, sociologjisë apo degë të tjera të lidhura me këtë fushë<sup>14</sup>.

## **Neni 26**

### **Mbikëqyrja e punonjësve dhe ekspertëve**

1. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe drejtorët e departamenteve kryejnë mbikëqyrjen administrative të punësimit, trajnimit, disiplinës dhe vlerësimit të punonjësve dhe ekspertëve të Prokurorisë së Posaçme, si dhe i caktojnë ata të punojnë me prokurorët.
2. Prokurorët e posaçëm mbikëqyrin çdo punonjës dhe ekspert në hetimet dhe çështjet që u janë caktuar.
3. Ekspertët nuk japin mendime të cilat mbështeten në udhëzimet e prokurorëve specialë për themelin. Ekspertët japin mendime të bazuara në prova, fakte, ekspertizë dhe rezultate analizash.

## **Neni 27**

### **Pushimi i çështjeve ose akuzave nga prokurori special**

1. Në çdo fazë të procedimit, nëse prokurori i posaçëm e konsideron të nevojshme të marrë vendim për të pushuar akuzat ose çështjen që është në kompetencën parësore ose dytësore sipas Neneve 10 dhe 11 të këtij ligji, prokurori i posaçëm është i detyruar të kërkojë miratimin e shumicës së mbledhjes së prokurorëve të posaçëm.

---

<sup>14</sup> Ndryshim për tu harmonizuar me parashikimin e Nenit 66 të projekt ligjit për Prokurorinë e Përgjithshme.

2. Një prokuror tjetër i posaçëm luan rolin e relatorit para mbledhjes dhe studion dosjen për jo më shumë se 15 ditë. Brenda 20 ditëve nga kërkesa, bëhet mbledhja dhe relatori paraqet raportin e tij nëse pushimi është i bazuar apo i pabazuar.
3. Pas raportimit, bëhet një votim i fshehtë për të miratuar ose rrëzuar kërkesën. Vendimi i mbledhjes merret me shumicë të thjeshtë të prokurorëve të posaçëm. Në rast barazimi të votave, vota e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme është vendimtare.
4. Nëse mbledhja vendos se kërkesa është e pabazuar, prokurori i posaçëm i caktuar ose drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme vazhdon procedimin penale. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, nëse është e nevojshme, zëvendëson në përputhje me Nenin 50 të Ligjit për Prokurorinë e Përgjithshme prokurorin e posaçëm të çështjes.<sup>15</sup>
5. Nëse mbledhja vendos se kërkesa është e bazuar, regjistrohet vendimi për të pushuar akuzat ose çështjen.

### **Neni 28 Apelimet**

1. Nuk ekzistojnë prokurori të veçanta për Gjykatën e Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, por prokurorët e posaçëm të Prokurorisë së Posaçme i përfaqësojnë çështjet e tyre në gjykatën e shkallës së parë, në gjykatën e apelit dhe në të gjitha nivelet e apelimit.
2. Prokurorët e posaçëm të Prokurorisë së Posaçme përfaqësojnë çështjet e tyre para Gjykatës së Lartë.
3. Prokurorë të tjerë të posaçëm të Prokurorisë së Posaçme ose, me kërkesë të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme ndihmojnë prokurorët e posaçëm për të përgatitur dhe mbrojtur apelimet, kur është e nevojshme.

## **KREU IV BASHKËPUNIMI ME ORGANET E TJERA**

### **Neni 29 Detyrimet e autoriteteve të tjerë shtetërorë**

1. Të gjithë organet e pushtetit shtetëror dhe të gjitha subjektet juridike të cilët, në kryerjen e aktiviteteve të tyre, vijnë në dijeni për rrethana dhe të dhëna që tregojnë një vepër penale të parashikuar në Nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, janë të detyruar t'i referojnë këto rrethana ose të njoftojnë menjëherë Byronë Kombëtare të Hetimit ose Prokurorinë e Posaçme.
2. Të gjithë organet e pushtetit shtetëror janë të detyruar të bashkëpunojnë me Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit për hetimin e çështjeve.

---

<sup>15</sup> Koment nga Think Tank, harmonizim me projekt ligjin për Prokurorinë e Përgjithshme.

3. Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit<sup>16</sup> ka akses të drejtpërdrejtë në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga organet shtetërore, që përmbajnë informacion të duhur për hetimin e veprave penale të parashikuar në Nenin 75/a të të Kodit të Procedurës Penale. Organet shtetërore kanë detyrimin të japin informacion brenda 24 orëve ose, në qoftë se baza e të dhënave ekziston, ti japin akses të drejtpërdrejtë Prokurorisë së Posaçme. Ky akses do të vendoset në mënyrë të përhershme brenda një afati kohor të arsyeshëm, por jo më gjatë se 6 muaj, në vijim të një kërkesë me shkrim nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme drejtuar kreut të organit shtetëror. Ky paragraf nuk zbatohet për sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave që janë të çetifikuara të përmbajnë sekrete shtetërore.

### **Neni 30**

#### **Detyrimet e Policisë së Shtetit**

1. Në qoftë se një punonjës i Policisë së Shtetit vjen në dijeni për kryerjen e një veprë penale, ai/a jo njofton menjëherë Byrosë Kombëtare të Hetimit<sup>17</sup>. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit nxjerr një rregullore mbi metodologjinë e informimit tek Byrja Kombëtare e Hetimit.<sup>18</sup>
2. Pas marrjes së informacionit të përmendur në paragrafin 1 të këtij Neni, Prokuroria e Posaçme nëse vlerëson se është kryer një veprë penale në kompetencë të saj, mund të fillojë punën për atë çështje. Ajo ia njofton këtë policisë dhe prokurorisë që kishte qene duke proceduar rastin deri në atë moment.
3. Në qoftë se prokurori i posaçëm në Prokurorinë e Posaçme vlerëson se nuk ka të dhëna për shkeljeve penale, për të cilat ata janë kompetentë, ia raporton këtë drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.
4. Pas raportimit, në qoftë se Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme çmon se vepra penale nuk i përket juridiksionit të kësaj prokurorie, njofton zyrën përkatëse të prokurorisë që do të vazhdojë procedurën, si dhe informon çdo strukturë tjetër të duhur<sup>19</sup>.
5. Në bazë të kërkesës së një prokurori të posaçëm, ose në përputhje me urdhërat e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, oficerët e Policisë së Shtetit shqiptar ose një agjent apo oficer i policisë gjyqësore duhet të hetojnë ose të asistojnë në hetimin e çdo çështje që është kompetencë e Prokurorisë së Posaçme.
6. Oficerët e Policisë së Shtetit shqiptar ose një agjent apo oficer i policisë gjyqësore bën kontrollë, arrestime ose ekzekuton urdhërat e tjera të lëshuara në përputhje me Kodin e Procedurës Penale nga një prokuror i posaçëm apo gjykatë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

<sup>16</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë; komente nga Think Tank.

<sup>17</sup> Inkorporim i komenteve të ndryshme.

<sup>18</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë; komente nga EURALIUS

<sup>19</sup> Koment i Ministrisë së Drejtësisë; komente nga Think Tank



**Neni 31**  
**Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme për**  
**Parandalimin e Pastrimit të Parave**

1. Nëse ekziston dyshim për pastrimit e produkteve të veprës penale, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave:
  - a) informon Prokurorinë e Posaçme për instrumente, të ardhura ose pasuri, për të cilat kanë ardhur në dijeni në çfarëdo mënyre, në qoftë se është e mundshme që këto të kenë qenë fituar përmes kryerjes së një vepre penale të parashikuar në Nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale;
  - b) kërkon nga subjektet e detyruara të zbatojnë masat kundër pastrimit të produkteve të veprës penale të gjitha të dhënat në lidhje me transaksionet e palëve të mbajtura nga subjektet që e kanë këtë detyrim dhe për t'ia dërguar këto të dhëna menjëherë Prokurorisë së Posaçme.
2. Me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave vë në dispozicion të gjitha të dhënat që ka mbi transaksionet e personave të dyshuar për pastrim të produkteve të veprës penale dhe kryen kontrollet e nevojshme me qëllim të vërtetimit të ekzistencës së këtyre transaksioneve.
3. Inspektorët shtetërorë të autorizuar për sekuestrimin e përkohshëm të objekteve, instrumenteve ose aseteve të dyshuara i dorëzojnë Prokurorisë së Posaçme, së bashku me njoftimin, një raport mbi veprimet e kryera dhe transkriptin e vendimit për konfiskimi apo sekuestrim.

**KREU V**  
**BYROJA KOMBËTARE E HETIMIT**

**Neni 32**  
**Byroja Kombëtare e Hetimit**

1. Byroja Kombëtare e Hetimit është një seksion i specializuar i policisë gjyqësore, që vepron vetëm nën drejtimin e Prokurorisë së Posaçme. Drejtori, zëvendës drejtori dhe hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit gëzojnë statusin e oficerit të policisë gjyqësore.
2. Byroja Kombëtare e Hetimit përbëhet nga drejtori, zëvendës drejtori, hetuesit dhe punonjësit e administratës.
3. Organizimi i brendshëm i Byrosë Kombëtare të Hetimit parashikohet nga urdhëri i përbashkët i Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.<sup>20</sup>
4. Byroja Kombëtare e Hetimit ka në përbërje të saj shërbime të policisë gjyqësore të përbëra nga oficerë të policisë gjyqësore nga Policia e Shtetit dhe institucionet e tjera përkatëse, nën drejtimin administrativ të Zëvendës Drejtorit. Punonjësit e

<sup>20</sup> Koment I Ministrisë së Drejtësisë.

shërbimeve mund të qëndrojnë në mjediset e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose ato të Policisë së Shtetit ose ato të institucioneve përkatëse sipas nevojave të përcaktuara nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Organizimi i shërbimeve të policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit përcaktohet në përputhje me këtë ligj përmes urdhërave të përbashkët të Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe drejtuesve të autoriteteve kompetente.

5. Buxheti i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe pagat e oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve të Byrosë Kombëtare të Hetimit përfshihet në buxhetin e Prokurorisë së Posaçme.

### **Neni 33**

#### **Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Kandidatët për punonjës apo oficerë të shërbimeve të policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit, përfshi drejtorin, zëvendës drejtorin, hetuesit, punonjësit dhe personat pranë shërbimeve të policisë gjyqësore, duhet të përmbushin kushtet e sigurisë të përcaktuar në këtë ligj, përfshirë verifikimin e personalitetit dhe heqjen dorë nga e drejta për privatësi në telekomunikime dhe llogari financiare, të firmosur nga kandidati dhe anëtarët e afërt të familjes. Një kandidat nuk mund të emërohet në Byrosë Kombëtare të Hetimit, apo në shërbimet e policisë gjyqësore pranë saj, pa përmbushur kriteret dhe pa iu nënshtruar kushteve të sigurisë.

2. Kandidatët për drejtor, zëvendës drejtor apo hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët janë në përputhje me paragrafin 1 dhe përpara emërimit, duhet të kenë përfunduar një program trajnimi të miratuar nga Komisioni i Pavarur i Rishikimit. Kandidatët për oficerë të policisë gjyqësore të shërbimeve, të cilët janë në përputhje me paragrafin 1 dhe brenda 2 muajve nga emërimi, duhet të kenë përfunduar një program trajnimi të miratuar nga Komisioni i Pavarur i Rishikimit.

### **Neni 34**

#### **Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Drejtori është përgjegjës për funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit.

2. Pas një procesi rekrutimi të hapur dhe transparent, një komision i përbërë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme me më shumë vite eksperiencë pune, rekomandojnë një kandidat për drejtor të Byrosë Kombëtare të Hetimit, i cili emërohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Drejtori ka mandat 5 vjeçar, me të drejtë riemërimi një herë.

3. Pas përfundimit të mandatit, Drejtori ka të drejtën të kthehet në pozicionin e mëparshëm ose të emërohet në një pozicion të njëjtë nivel, me një gradë që i korrespondon atij funksioni.

4. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit raporton tek një komision i përbërë prej tre prokurorësh të Prokurorisë së Posaçme, njëri prej të cilëve është drejtuesi i saj dhe dy të tjerët zgjidhen çdo vit me short.

5. Drejtori përzgjedh nga rradhët e hetuesve një zëvendës drejtor, me pëlqimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Zëvendës drejtori vepron në emër të drejtorit, në mungesë të tij.

6. Drejtori cakton hetues për të drejtuar sektorë brenda Byrosë Kombëtare të Hetimit në përputhje me urdhërin e përbashkët të nxjerrë në bazë të Nenit 33, paragrafi 3.<sup>21</sup>

### **Neni 35**

#### **Emërimi i Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Drejtori mund të vijë nga rradhët e Policisë së Shtetit, policisë gjyqësore, ose hetueve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Një prokuror i cili përmbush kërkesat e paragrafit 3 mund të jetë gjithashtu kandidat.

2. Kandidati për t'u emëruar si drejtor duhet të ketë reputacion të njohur si person me integritet dhe i njohur për një punë me standardet më të larta profesionale.

3. Kandidati për postin e drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të ketë të njëjtat kualifikime për të qenë hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit sipas Neneve 39 dhe 40, dhe, përpara se të fillojë detyrën, duhet të kryejë apo të ketë kryer kursin e miratuar të trajnimit.

4. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

a. të ketë vetëm shtetësinë shqiptare;

b. të ketë arsim të lartë policor ose arsim të lartë në drejtësi apo ekonomi;

c. nëse kandidati është punonjës i Policisë së Shtetit, ai kandidat duhet të mbajë gradën “Drejtues i Parë” ose “Drejtues”;

ç. të ketë përvojë mbi shtatë vjet në hetimin e veprave penale në fushën e korrupsionit, krimin të organizuar apo krimeve të rënda;

d. të ketë aftësi të larta profesionale dhe cilësi të larta morale;

dh. të mos jetë nën efektet e një mase disiplinore, ose të jetë nën hetim apo gjykim për një vepër penale<sup>22</sup>;

e. të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një veprë penale në Shqipëri apo vende të tjera;

ë. të ketë kaluar me sukses testin e poligrafit për integritetin dhe motivimin.

### **Neni 36**

#### **Lirimi/shkarkimi nga detyra i Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit lirohet nga detyra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë kur;

a. i mbaron mandati;

b. paraqet dorëheqjen;

c. arrin moshën e pensionit;

<sup>21</sup> Bazuar ne komentet e KT të Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>22</sup> Koment I Ministrisë së Drejtësisë

- ç. kur aftësia për të ushtruar detyrën i është kufizuar shumë me vendim gjyqësor të formës së prerë.
2. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në rekomandimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kur:
- a. dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një veprë penale;
  - b. për shkelje të Kushtetutës apo për shkelje të rëndë të ligjit gjatë kryerjes së detyrës;
  - c. për shkelje të rënda dhe shumë të rënda të disiplinës gjatë ushtrimit të funksioneve;
  - ç. kur dalin fakte të reja që janë verifikuar dhe janë<sup>23</sup> në kundërshtim me kriteret e përcaktuara për emërimin e tij.
3. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit pezullohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rekomandimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, nëse drejtori bëhet subjekt i një hetimi penal. Pezullimi vazhdon për aq kohë sa do egzistojnë shkaqet e këtij pezullimi.

### **Neni 37**

#### **Zëvendës Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Zëvendës Drejtori është përgjegjës për funksionimin e shërbimeve të policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Zëvendës Drejtori është përgjegjës për funksionimin e vazhdueshëm të Byrosë Kombëtare të Hetimit gjatë çdo mungese të Drejtorit.
2. Zëvendës Drejtori është hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit, dhe ka të paktën 3 vjet eksperiencë pune në hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar apo krimeve të rënda, si dhe duhet të ketë treguar aftësi të menaxhimit të personave të ndryshëm.
3. Pas një procesi të hapur dhe transparent të përzgjedhjes, Drejtori emëron një Zëvendës Drejtor me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme. Zëvendës Drejtori emërohet për një mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë.
4. Pas mbarimit të mandatit, Zëvendës Drejtori gëzon të drejtën të kthehet në pozicionin e mëparshëm si hetues.
5. Zëvendës Drejtori raporton tek Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.
6. Zëvendës Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit shkarkohet nga detyra nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rekomandimet e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kur:
  - a. dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një veprë penale;
  - b. për shkelje të Kushtetutës apo për shkelje të rëndë të ligjit gjatë kryerjes së detyrës;

---

<sup>23</sup> koment I Ministrisë së Drejtësisë

c. për shkelje të rënda dhe shumë të rënda të disiplinës gjatë ushtrimit të funksioneve;

ç. kur dalin fakte të reja që janë verifikuar dhe janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara për emërimin e tij.

7. Zëvendës Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit pezullohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rekomandimin e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, nëse zëvendës drejtori bëhet subjekt i një hetimi penal. Pezullimi vazhdon për aq kohë sa do egzistojnë shkaqet e këtij pezullimi.

### **Neni 38**

#### **Hetuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Hetuesit kryejnë hetime nën drejtimin e prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme.
2. Kandidatët për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit përzgjidhen pas një procesi rekrutimi dhe aplikimi të hapur e transparent. Procesi i rekrutimit parashikohet në një rregullore, që mbështetet në praktikat më të mira të rekrutimeve konkurruese, që nxirret nga Drejtori në përputhje me Nenin 40.
3. Një person mund të emërohet si hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit vetëm pasi të ketë përfunduar trajnimin e kërkuar dhe të ketë shfaqur aftësitë për kryerjen e detyrave sipas standardeve të kërkuara profesionale.
4. Emërimi i një hetuesi në Byrosë Kombëtare të Hetimit kryhet nga Drejtori, me pëlqimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.
5. Hetuesit mund të caktohen nga drejtori apo drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme të punojnë me një prokuror të caktuar të Prokurorisë së Posaçme. Hetuesi nuk mund të caktohet në një detyrë tjetër pa pëlqimin e prokurorit të posaçëm ose të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

### **Neni 39**

#### **Kriteret për emërimin dhe largimin e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Kandidati për hetues në Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të plotësojë këto kriteret:
  - a. është shtetas shqiptar;
  - b. ka arsim të lartë policor, në drejtësi apo kontabilitet apo arsim të lartë në degë të tjera që kanë lidhje me misionin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, në një universitet vendas apo të huaj;
  - c. ka një përvojë më shumë se 1 vjeçare pune në polici, në institucionet e zbatimit të ligjit<sup>24</sup> ose në një fushë ku kërkohen njohuri specifike;
  - ç. plotësimi me sukses i kriterëve të përzgjedhjes dhe trajnimit për Byrosë Kombëtare të Hetimit.

<sup>24</sup> Koment I Ministrisë së Drejtësisë

2. Të gjithë punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit me detyra hetimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, duhet të kryejnë me sukses të gjitha fazat e mëposhtme të përzgjedhjes:

- a. plotësimin e një aplikimi online, përfshirë një *curriculum vitae* elektronike dhe dokumentet mbështetëse, si dhe një deklaratë me shkrim mbi motivimin për t'u bërë pjesë e Byrosë Kombëtare të Hetimit;
  - b. një provim me shkrim e me gojë ku përfshihen teste konjitive, të sjelljes dhe të arsytimit logjik;
  - c. një provim të zgjeruar me shkrim që mat aftësitë e shkrimit të raporteve, si dhe nivelin e shkrimit e këndimit;
  - ç. një intervistë nga një panel që mat aftësitë e komunikimit verbal, si dhe aftësinë për t'i komunikuar idetë me efikasitet;
  - d. një testim të aftësive fizike që mat forcën dhe rezistencën fizike; dhe një test të poligrafit për integritet dhe motivim; dhe
  - e. një hetim mbi verifikimin e figurës, i cili konfirmon se personi nuk është dënuar e nuk është shpallur më parë fajtor për vepra penale.
3. Pasi pranohet si kandidat, personi i nënshtrohet një regjimi rigoroz trajnimi dhe arsimimi, me një sërë modulesh vlerësimi që duhen kaluar për t'u certifikuar. Pasi është certifikuar si i trajnuar dhe i aftë, kandidati i jepet distinktivi i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe konsiderohet hetues.
4. Kursi i trajnimit dhe arsimimit, standardet profesionale dhe sistemet e vlerësimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit miratohen nga drejtori, me pëlqimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në konsultim me Bordin e Pavarur të Rishikimit.
5. Procedurat për shqyrtimin e procedimeve disiplinore dhe llojet e masave disiplinore përcaktohen në këtë ligj, si edhe në Ligjin për Organizimin dhe Funksonimin e Policisë Gjyqësore.
6. Të gjithë hetuesit janë të detyruar të marrin një notë kaluese në secilin prej testeve të përmendur në paragrafin 2, pikat b), dh) dhe e) si parakusht për t'u rinovuar emërimi i tyre çdo dy vjet.

#### **Neni 40**

##### **Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Byroja Kombëtare e Hetimit, në mënyrë që të rrisë bashkëpunimin dhe komunikimin midis Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe institucioneve të tjera, si dhe të ndihmojë në hetimet e Prokurorisë së Posaçme që kryhen nga institucione të tjera, ka në përbërje të saj Shërbime të Policë Gjyqësore.
2. Oficerët e përzgjedhur nga rradhët e shërbimeve të policisë gjyqësore caktohen nga institucionet e tyre përkatëse për një mandat 5 vjeçar për të punuar pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit. Gjatë këtij mandati, ata do të paguhen nga Byroja Kombëtare e Hetimit, do të raportojnë tek Zëvendës Drejtori dhe do të vlerësohen nga Zëvendës Drejtori. Në përfundim të këtij mandati, Zëvendës Drejtori dërgon vlerësimet tek institucioni prej të cilit ka ardhur oficeri i policisë gjyqësore.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nxjerr rregullore të përbashkët me Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit për konfirmimin/emërimin e individëve të kualifikuar për në Shërbimet e Policisë Gjyqësore. Policia e Shtetit organizon nje proces aplikimi te hapur dhe transparent, në përputhje me këtë ligj, nga rradhët e punonjësve të kualifikuar të drejtorive që janë përgjegjëse për hetimin e krimit të organizuar, krimit ekonomik, trafikimit të narkotikëve, si dhe sektorëve të tjerë përkatës. Përmes procesit të aplikimit njoftohen aplikuesit se oficerët për në Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të përmbushin kriteret e Nenit 51. Aplikuesit duhet të përmbushin kriteret e Nenit 51 përpara se ata të caktohen apo emërohen pranë Shërbimeve të Policisë Gjyqësore.
4. Institucionet e tjera, që ushtrojnë funksione të policisë gjyqësore, nxjerrin rregullore të përbashkëta me Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit për konfirmimin/emërimin e individëve të kualifikuar për në Shërbimet e Policisë Gjyqësore. Institucionet përkatëse organizonjë nje proces aplikimi te hapur dhe transparent për punonjësit e kualifikuar. Përmes procesit të aplikimit njoftohen aplikuesit se oficerët për në Shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të përmbushin kriteret e Nenit 51. Aplikuesit duhet të përmbushin kriteret e Nenit 51 përpara se ata të caktohen apo emërohen pranë Shërbimeve të Policisë Gjyqësore.
5. Oficerët e Shërbimeve të Policisë Gjyqësore qëndrojnë në zyrat nga ku ata kanë ardhur ose në zyrat e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit vendos se ku do të qëndrojnë ata.
6. Kur Drejtori ose Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme e konsideronjë të nevojshme, Byroja Kombëtare e Hetimit cakton hetues nga zyra e saj të vendosen pranë Policisë së Shtetit ose institucioneve të tjera. Policia e Shtetit ose institucionet e tjera marrin përsipër të zbatojnë këtë vendim.

#### **Neni 41**

##### **Statusi i policisë gjyqësore**

1. Drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore, janë oficerë të policisë gjyqësore por nuk janë nën kontrollin e Prokurorit të Përgjithshëm apo të Ministrisë apo ndonjë strukture tjetër përgjegjëse për rendin publik dhe sigurinë.<sup>25</sup> Ata janë vetëm nën kontrollin e Prokurorëve të Posaçëm.
2. Hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve punojnë dhe komunikojnë drejtpërsëdrejti me prokurorët e posaçëm.
3. Punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit ruajnë sekretin e hetimeve penale në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjet e tjera të zbatueshme.

---

<sup>25</sup> bazuar në komentimin e Ministrisë së Drejtësisë

## **Neni 42**

### **Largimi i punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Pas përfundimit të trajnimit të nevojshëm, si dhe emërimit si anëtar i Byrosë Kombëtare të Hetimit, anëtari shërben për një periudhë jo më të shkurtër se shtatë vjeçare në Byrosë Kombëtare të Hetimit, përveçse nëse shkarkohet në përputhje me këtë dispozitë.
2. Punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit shkarkohet nga drejtori, vetëm pas konsultimit me Komisionin e Pavarur të Rishikimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe me pëlqimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, nëse është:
  - a. dënuar për një vepër penale nga një gjykatë penale në Shqipëri apo në ndonjë vend tjetër;
  - b. vlerësuar nga një panel mjekësh ekspertë si i paaftë nga ana shëndetësore për të qenë anëtar i Byrosë Kombëtare të Hetimit për të përmbushur detyrat dhe funksionet të parashikuara nga ky ligj;
  - c. në përfundim të një procedure disiplinore, e cila e ka gjetur punonjësën e Byrosë Kombëtare të Hetimit në shkelje të rregullave të zbatueshme të sjelljes profesionale në më shumë se tre raste, dhe ai vlerësohet si i papërshtatshëm profesionalisht për të ushtruar detyrat e tij; ose
  - ç. punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit shkarkohet edhe kur dalin dhe vërtetohen fakte të reja, të panjohura më parë, të cilat kanë lidhje me arsimimin, kualifikimet apo besueshmërinë e punonjësit apo të cilat kanë lidhje dhe janë në mospërputhje me kriteret për emërimin e tij.

## **Neni 43**

### **Oficeri Përgjegjës për Mbikqyrjen**

1. Oficeri Përgjegjës për mbikqyrjen është një hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit me diplomë në drejtësi me të paktën pesë vite përvojë si oficer i policisë gjyqësore.
2. Oficer Përgjegjës për Mbikqyrjen emërohet një hetues i vetëm me short për një mandat 2 vjeçar, pa të drejtë riemërimi të menjëhershëm. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, në prezencë të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe Kryetarit të Gjykatës së Shkallën së Parë për Anti-Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, bën përzgjedhjen me short.
3. Oficeri përgjegjës kryen vëzhgimin periodik të telekomunikimeve të kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, drejtuesit, prokurorëve dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit dhe hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerëve të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore, si dhe të anëtarëve të afërt të familjeve të personave të mësipërm. Oficeri përgjegjës nuk ka përgjegjësi të tjera hetimore apo administrative.
4. Oficeri Përgjegjës raporton çdo informacion që ngre dyshime të arsyeshme për veprimtari korruptive apo kriminale tek një prokuror çfarëdo i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, i cili nuk duket i përfshirë



në veprimtarinë e dyshimtë. Oficeri përgjegjës e kryen këtë raportim tek prokurorë të ndryshëm, me rotacion.

5. Oficeri përgjegjës ruan regjistra të telekomunikimeve, të cilat ngrenë dyshime të arsyeshme për veprimtari të papërshtatshme apo kriminale, por të gjitha regjistrimet apo shënimet e tjera i shkatërron brenda 3 ditësh, me përjashtim të rasteve kur ruajtja e tyre urdhërohet me shkrim nga një prokuror apo gjykatë.

6. Oficeri Përgjegjës raporton shkelje të etikë së gjyqtarëve apo prokurorëve Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

#### **Neni 44**

##### **Pagat dhe buxheti i Byrosë Kombëtare të Hetimit**

1. Pagat dhe shtesat e pagave të punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe të oficerëve të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Pagat dhe shtesat nuk mund të ulen me vendime të mëvonshme të Këshillit të Ministrave.

2. Çdo vit, drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit i paraqet drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme një projekt-buxhet dhe drejtuesi i paraqet Ministrit të Financave një projekt-buxhet të bashkuar.

3. Për të mbuluar nevojat vjetore për automjete, shpenzime dhe shpërblime, Byroja Kombëtare e Hetimit përdor deri në 20% të fondit të posaçëm të krijuar nga veprimtaritë e saj, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Kriteret dhe metodat e përdorimit të këtij fondi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në propozimin e Ministrit të Financave.

#### **Neni 45**

##### **Marrëdhëniet e Byrosë Kombëtare të Hetimit me struktura të tjera policore**

1. Drejtori është i autorizuar të firmosë marrëveshje me struktura të tjera policore për të përmirësuar efikasitetin, kapacitetin operacional dhe shkëmbimin e informacionit.

2. Policia e Shtetit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Policia Kufitare, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe të gjitha institucionet e tjera përkatëse shtetërore bashkëpunojnë me kërkesat e ligjshme të hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

3. Byroja Kombëtare e Hetimit ka akses në informacionin që përmbajnë bazat e të dhënave me interes, përfshirë Sistemin e Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS).

4. Byroja Kombëtare e Hetimit përcaktohet si një vend ku ekzekutohen urdhërat për përgjim të kërkuar nga Prokuroria e Posaçme dhe të urdhëruar nga gjykatat kundër korrupsionit dhe kriminimit të organizuar si dhe për të ushtruar detyra të tjera të parashikuara në Nenin 43, si dhe do të ketë kapacitetet e veta për t'i kryer detyrat si më sipër.

### **Neni 46**

#### **Komisioni i Pavarur i Rishikimit**

1. Komisioni i Pavarur i Rishikimit i Byrosë Kombëtare të Hetimit përbëhet nga ekspertë të drejtësisë penale, të caktuar nga misionet e Bashkimit Evropian dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri. Çdo mision cakton përfaqësuesit, të cilët japin udhëzime dhe këshilla ekspertësh për një funksionim më të mirë dhe për zhvillimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit.
2. Komisioni i Pavarur i Rishikimit vëzhgon në mënyrë aktive procesin e rekrutimit dhe trajnimit të punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, vendimet për të shkarkuar punonjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe sigurin respektimin e ligjeve në fuqi.

## **KREU VI**

### **PUNONJËSIT E GJYKATAVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE ORGANEVE TË SPECIALIZUARA TË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

#### **Neni 47**

#### **Mbrojtja sipas shërbimit civil për punonjësit e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar**

1. Punonjësit e administratës gjyqësore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar u nënshtrohen dispozitave përkatëse të Ligjit për Organizimin e Gjykatave, përveçse nëse parashikohet ndryshe në këtë ligj.
2. Punonjësit e administratës së prokurorisë pranë Prokurorisë së Posaçme u nënshtrohen dispozitave përkatëse të Ligjit për Nëpunësin Civil, përveçse nëse parashikohet ndryshe në këtë ligj.

#### **Neni 48**

#### **Standardet e sjelljes së punonjësve**

Punonjësit e administratës gjyqësore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, punonjësit e administratës të Prokurorisë së Posaçme dhe punonjësit e administratës të Byrosë Kombëtare të Hetimit u nënshtrohen këtyre kushteve të posaçme:

1. janë të detyruar të bëjnë deklaramin financiar vjetor në Inspektoratin e Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesit. Mosdeklarimi ose deklarimi jo i plotë apo i remë përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm;
2. janë të detyruar t'i dorëzojnë Oficerit Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit një deklaratë ku të rendisin të gjithë anëtarët e familjes të vetë

punonjësit dhe bashkëshortin/es: fëmijët, nipërit, motrat/vëllezërit, prindërit, gjyshërit, tezet/hallat, xhaxhallarët/dajat, kushërinjtë e parë, si dhe kushërinjtë e dytë. Punonjësit kanë detyrimin e vazhdueshëm të përditësojnë deklaratën sipas nevojës dhe të deklarojnë çdo konflikt interesi tek kancelari apo tek gjyqtari apo prokurori përkatës. Mosdorëzimi apo mospërditësimi i deklaratës apo deklarimi jo i plotë apo i rremë përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm.

3. kanë detyrimin e vazhdueshëm t'i deklarojnë drejtorit apo Oficerit Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme çdo kontakt me persona, të cilët i kanosin, u ofrojnë ryshfet apo para për të marrë informacion apo në këmbim të veprimeve që kanë lidhje me një hetim apo çështje të zyrës. Mosdeklarimi i këtyre kontakteve apo deklarimi jo i plotë apo i rremë përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm.

4. kanë detyrimin e vazhdueshëm të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin e dëshmitarëve, provave, dokumenteve dhe të çdo informacioni tjetër në lidhje me hetimet e Zyrës, me përjashtim të rasteve kur këto informacione janë bërë publike tashmë në përputhje me ligjin. Shkelja e këtij detyrimi përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm.

## **KREU VII**

### **SIGURIA E GJYKATAVE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE PROKURORISË SË POSAÇME**

#### **Neni 49**

##### **Siguria e mjediseve**

Policia e Shtetit garanton në mënyrë të vazhdueshme sigurinë e mjediseve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të Prokurorisë së Posaçme dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Shërbimet e sigurisë të Policisë së Shtetit kryejnë detyrat e tyre nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e kryetarit të gjykatës përkatëse kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe të drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, respektivisht. Rregullat e hollësishme mbi procedurat në lidhje me garantimin e sigurisë së këtyre institucioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### **Neni 50**

##### **Siguria e personelit**

1. Në zbatim të Nenit 21 të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, u sigurohet mbrojtja personale sipas kërkesës, për si më poshtë:

- a. kryetarët e gjykatave, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit mbrohen me shoqërim, me oficer e nënoficer;
  - b. gjyqtarët dhe prokurorët me shoqërim, me oficer.
2. Nëse kërkohet përkatësisht nga kryetari i gjykatës apo drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sigurohet mbrojtje për anëtarëve e familjes, banesat dhe/ose eskortë për gjyqtarëve dhe prokurorët.
  3. Drejtorit, zëvendës drejtorit ose hetuesve të Byrosë Kombëtare të Hetimit si dhe anëtarëve të familjeve të tyre, për shkak të apo gjatë ushtrimit të detyrës, u sigurohet mbrojtje personale e jetës, shëndetit dhe pronës, nëse kërkohet nga drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.
  4. Rregullat e detajuara mbi procedurat e sigurisë sipas kesaj dispozite parashikohen në vendimin e Këshillit të Ministrave.
  5. Oficerët dhe nënoficerët e caktuar për sigurinë e gjyqtarëve, prokurorëve, anëtarëve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, familjeve dhe banesave të tyre nuk zëvendësohen pa marrë paraprakisht miratimin e kryetarit të gjykatës, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme apo drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, përkatësisht.

## **KREU VIII**

### **KUSHTET E SIGURISË PËR BESIMIN DHE KONFIDENCIALITETIN**

#### **Neni 51**

#### **Heqja dorë nga të drejtat si kusht për caktimin në detyrë, emërimin dhe aksesin në informacion**

1. Përpara emërimit, kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për drejtor, zëvendës drejtor, hetues, oficer të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byrosë Kombëtare të Hetimit firmosin një deklaratë me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për pritshmëri për privatësi (jetën private) në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare. Kjo deklaratë firmoset përpara se ata të caktohen me detyrë apo të punësohen.
2. Edhe anëtarët e afërt të familjeve të personave të përmendur në paragrafin 1 firmosin deklaratën për heqjen dorë nga të drejtat, si tregues se i kuptojnë kushtet.
3. Pas caktimit me detyrë apo punësimit, gjyqtarët dhe pozicionet e tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorët dhe pozicionet e tjera në Prokurorinë e Posaçme, drejtori, zëvendës drejtori, hetues, oficerë të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byrosë Kombëtare të Hetimit kanë nga një telefon celular, adresë poste elektronike dhe numër telefoni të dhënë nga gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar apo organet e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe bien dakord të përdorin vetëm ata numra telefoni dhe adresa poste elektronike. Ata nuk

lejohen të përdorin asnjë formë tjetër komunikimi elektronik. Numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike i nënshtrohen vëzhgimit nga Oficeri Përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

4. Gjyqtarët dhe pozicionet e tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokurorët dhe pozicionet e tjera në Prokurorinë e Posaçme, drejtori, zëvendës drejtori, hetuesit, oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit deklarojnë llogaritë e tyre financiare, si dhe ato të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre tek Oficeri Përgjegjës brenda Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Llogaritë financiare i nënshtrohen vëzhgimit nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Të gjitha llogaritë e reja deklarohen brenda 3 ditëve.

5. Deklarata e heqjes dorë për gjyqtarët dhe prokurorët përmban këtë tekst: “Unë jam i informuar se do të caktohem me detyrë në një post që duhet të ketë besimin e posaçëm të publikut, për një mandat dhjetë vjeçar. Unë jam i informuar dhe jam dakord që për këto dhjetë vite do të marr një telefon celular, një numër celulari dhe një adresë poste elektronike. Jam dakord të përdor vetëm këto mjete komunikimi elektronik. Nëse gjatë një emergjence do të më duhet të përdor një mjet tjetër komunikimi elektronik, do t’ia raportoj këtë fakt Oficerit Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit brenda 3 ditësh. Jam i informuar dhe dakord që ky numër telefoni dhe kjo adresë poste elektronike i nënshtrohen vëzhgimit nga Byroja Kombëtare e Hetimit, ku përfshihet leximi i emaileve, mesazheve tekst si dhe dëgjimi i bisedave. Jam i informuar dhe dakord për të deklaruar llogaritë e mia financiare dhe ato të anëtarëve të afërt të familjes sime, si dhe për të deklaruar çdo llogari të re që mund të krijojmë. Jam i informuar dhe dakord që këto llogari do të vëzhgohen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Jam i informuar dhe dakord që nëse nuk i respektoj këto kushte, mund të përballlem me masa disiplinore, ndër të cilat mund të jetë ndërprerja e mandatit im. Jam i informuar gjithashtu se informacioni i përfutur nga ky vëzhgim mund të përdoret në ndjekje penale, nëse ka prova për një vepër penale. Jam i informuar dhe dakord se këto kushte janë të rëndësishme dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën për të kryer hetime, ndjekje penale dhe gjykime çështjesh të rëndësishme larg korrupsionit. Gjithashtu jam dakord që, në këmbim të këtyre kushteve, unë kompensohem me një pagesë shtesë.”

6. Deklarata e heqjes dorë nga të drejtat për Drejtorin, zëvendës drejtorin, hetuesit, oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore dhe pozicione të tjera të Byrosë Kombëtare të Hetimit, punonjësit e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe punonjësit e prokurorisë së posaçme, përmban këtë tekst: “Unë jam i informuar se do të caktohem me detyrë në një post që duhet të ketë besimin e posaçëm të publikut. Gjatë punësimit tim, jam i informuar dhe kuptoj se do të marr një telefon celular, një numër celulari dhe një adresë poste elektronike. Jam dakord të përdor vetëm këto mjete komunikimi elektronik. Nëse gjatë një emergjence do të më duhet të përdor një mjet tjetër komunikimi elektronik, do t’ia raportoj këtë

fakt Oficerit Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Jam i informuar dhe dakord që ky numër telefoni dhe kjo adresë poste elektronike i nënshtrohen vëzhgimit nga Oficeri Përgjegjës i Byrosë Kombëtare e Hetimit, ku përfshihet leximi i emaileve, mesazheve tekst si dhe dëgjimi i bisedave. Jam i informuar dhe dakord për të deklaruar llogaritë e mia financiare dhe ato të familjarëve të mi të afërm, si dhe për të deklaruar çdo llogari të re që mund të krijojme. Jam i informuar dhe dakord që këto llogari do të vëzhgohen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Jam i informuar dhe dakord që nëse nuk i respektoj këto kushte, mund të përballem me masa disiplinore, ndër të cilat mund të jetë ndërprerja e punësimit im. Jam i informuar gjithashtu se informacioni i përftuar nga ky vëzhgim mund të përdoret në ndjekje penale, nëse ka prova për një vepër penale.”

## **Neni 52**

### **Deklarimet dhe kontrollet fillestare për gjyqtarët, prokurorët, anëtarët e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe anëtarët e afërt të familjes**

1. Përpara se një kandidat për gjyqtar të caktohet në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar apo një kandidat për prokuror të caktohet me detyrë në Prokurorinë e Posaçme, apo një kandidat të emërohet ose caktohet me detyrë në Byrosë Kombëtare të Hetimit ose në strukturat e saj të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore, ai ose ajo duhet të ketë qenë vlerësuar dhe kualifikuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimeve ose të ketë kryer dhe kaluar këto deklaratime dhe standarde:
  - a. kandidati dhe anëtarët e afërt të familjes plotësojnë një deklaratë pasurive në përputhje me Ligjin për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, Detyrimeve Financiare të Personave të Zgjedhur dhe Disa Zyrtarëve Publikë, Ligji nr. 9049 (i ndryshuar). Kryeinspektori i Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit bën llogaritjen e të ardhurave të ligjshme të familjes si dhe të pasurive faktike. Kandidati nuk ka të drejtë të emërohet në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar apo Prokurorinë e Posaçme nëse ka pasuri me vlerë më shumë se 133% e pasurive të cilat mund të shpjegohen nga të ardhurat e tij/saj të ligjshme. Gjithashtu, kandidati nuk ka të drejtë të emërohet as nëse nuk ka bërë një deklaram të saktë të pasurive të tij/saj;
  - b. kandidati plotëson një deklaratë personale, ku rendit:
    - i. emrin, datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë, vendbanimet brenda e jashtë Shqipërisë në të kaluarën, si dhe arsimin;
    - ii. emrin, datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë, adresën dhe punësimin e bashkëshortit/es, fëmijëve, vëllezërve/motrave, prindërve dhe vjehrrëve;
    - iii. emrin, datëlindjen, vendlindjen dhe shtetësinë e nipërve, gjyshërve, xhaxhallarëve/dajave, tezeve/hallave, kushërinjve të parë dhe kushërinjve të dytë për kandidatin dhe bashkëshortin/en;

iv. nga 1 janari 2000, çdo arrestim, vendim fajësie, dënim të formës së prerë, apo mandat arresti të lëshuar nga autoritete vendase apo të huaja për cilindo person të përmendur në nën-paragrafet ii) dhe iii), në dijeni të kandidatit;

v. nga 1 janari 2010, të gjitha vendet në të cilat ka udhëtuar kandidati si dhe datat e përafërta të udhëtimit;

vi. nga 1 janari 2010, të gjitha shtëpitë, apartamentet, shtëpitë e pushimit, automjetet, motorrët, mjetet lundruese apo aeroplanët të cilët kanë qenë nën pronësinë e kandidatit apo i janë dhënë në përdorim përveçse për qëllime zyrtare të ushtrimit të profesionit, dhe vii. kandidati është i detyruar të japë një listë të të gjitha takimeve, marrëdhënieve apo komunikimeve, me përjashtim të takimeve apo komunikimeve që kanë lidhje me pozicionin e tij si gjyqtar apo prokuror, me persona të cilët, në dijeninë e kandidatit, janë arrestuar, dënuar apo akuzuar publikisht për krim të organizuar.

c. Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Shërbimi Informativ Shtetëror i dorëzojnë nga një raport secili Këshillit të Lartë Gjyqësor apo Këshillit të Lartë të Prokurorisë ku konfirmojnë nëse deklarimi i bërë sipas paragrafit 1(b) është i plotë dhe i saktë, dhe nëse në të përmendet ndonjë person me lidhje të njohura me një organizatë kriminale. Në raporte jepen informacione mbi çdo lidhje të mundshme. Kandidati nuk caktohet me detyrë në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar apo në Prokurorinë e Posaçme nëse ai apo familja e tij kanë lidhje me krimin e organizuar.

### **Neni 53**

#### **Deklarimet dhe kontrollet fillestare për punonjësit dhe anëtarët e afërt të familjes**

1. Përpara se një punonjës të caktohet me detyrë si punonjës i gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në Prokurorinë e Posaçme apo në Byronë Kombëtare të Hetimit, ai duhet të ketë kryer dhe kaluar këto deklarime dhe standarde:

a. aplikuesi për tu bërë punonjës si dhe familjarët e afërm, plotësojnë një deklaratë pasurie në përputhje me Ligjin nr. 9049. Kryeinspektori i Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit bën llogaritjen e të ardhurave të ligjshme të familjes si dhe të pasurive faktike. Personi nuk ka të drejtë të punësohet në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në Prokurorinë e Posaçme apo në Byronë Kombëtare të Hetimit nëse ka pasuri me vlerë më shumë se 125% e pasurive të cilat mund të shpjegohen nga të ardhurat e tij të ligjshme. Gjithashtu, aplikuesi nuk ka të drejtë të emërohet as nëse nuk ka bërë një deklaram të saktë të pasurive të tij;

b) aplikuesi plotëson një deklaratë personale, ku rendit:

- i. emrin, datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë, vendbanimet jashtë Shqipërisë në të kaluarën, si dhe arsimin;
- ii. emrin, datëlindjen, vendlindjen, shtetësinë, adresën dhe punësimin e bashkëshortit/es, fëmijëve, vëllezërve/motrave, prindërve dhe vjehrrëve;
- iii. emrin, datëlindjen, vendlindjen dhe shtetësinë e xhaxhallarëve/dajave, tezeve/hallave dhe kushërinjve të parë për personin dhe bashkëshortin/en;
- iv. nga 1 janari 2000, çdo arrestim, vendim fajësie, dënim të formës së prerë, apo mandat arresti nga autoritete vendase apo të huaja për cilindo person të përmendur në nën-paragrafet a) dhe b), në dijeni të personit;
- v. nga 1 janari 2010, të gjitha vendet në të cilat ka udhëtuar personi si dhe datat e përafërta të udhëtimit;
- vi. nga 1 janari 2010, të gjitha shtëpitë, apartamentet, shtëpitë e pushimit, automjetet, motorrët, mjetet lundruese apo aeroplanët të cilët kanë qenë nën pronësinë e personit apo i janë dhënë në përdorim përveçse për qëllime zyrtare të ushtrimit të profesionit, dhe
- vii. personi është i detyruar të japë një listë të të gjitha takimeve, marrëdhënieve apo komunikimeve, me përjashtim të takimeve apo komunikimeve që kanë lidhje me pozicionin e tij, me persona të cilët, në dijeninë e tij/saj, janë arrestuar, dënuar apo akuzuar publikisht për krim të organizuar.

c. Byroja Kombëtare e Hetimit dhe Shërbimi Informativ Shtetëror i dorëzojnë nga një raport secili autoritetit kompetent të emërtesës dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, ku konfirmojnë nëse deklarimi i bërë sipas paragrafit 1(b) është i plotë dhe i saktë, dhe nëse në të përmendet ndonjë person me lidhje të njohura me një organizatë kriminale. Në raporte jepen informacione mbi çdo lidhje të mundshme. Aplikuesi nuk caktohet me detyrë në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në Prokurorinë e Posaçme apo në Byronë Kombëtare të Hetimit nëse ai apo familja e tij kanë lidhje me krimin e organizuar.

## **Neni 54**

### **Mbikqyrja e vazhdueshme**

1. Llogaritë financiare të kryetarëve të gjykatave, të gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve të posaçëm dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, të drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të tjerë të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si edhe të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre vëzhgohen në përputhje me Nenin 55. Telekomunikimet e kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve, drejtuesit, prokurorëve, drejtorit,



zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit mbikqyren në përputhje me Nenin 56.

2. Oficeri Përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave bashkërendojnë veprimtaritë e tyre dhe takohen sipas nevojës, por jo më rrallë se një herë në muaj, për të diskutuar mbi veprimtari të dyshimta.

3. Oficeri Përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, nëse nga vëzhgimi i vazhdueshëm del informacion që mbështet një dyshim të arsyeshëm për veprimtari kriminale, ia raportojnë atë dyshim të arsyeshëm një prokurori çfarëdo të Prokurorisë së Posaçme i cili nuk është i përfshirë në atë veprimtari.

### **Neni 55**

#### **Kontrollet dhe vëzhgimet që kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave**

1. Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave cakton një punonjës të saj, në konsultim me drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, për të mbikqyrur llogaritë financiare të kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerëve të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë kombëtare të Hetimit si dhe të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre. Ky person është përgjegjës për kallëzimin e çdo vepre penale të mundshme dhe ka atributet e policisë gjyqësore. Ky pozicion i kalon një punonjësi tjetër me rotacion çdo 2 vjet. Oficeri Përgjegjës nuk ka përgjegjësi të tjera.

2. Oficeri Përgjegjës kryen ruajtjen e të dhënave për gjashtë muaj dhe, në rast se nuk urdhërohet nga një prokuror i Prokurorisë së Posaçme t'i ruajë të dhënat për më gjatë, i shkatërron ato pas muajit të gjashtë. Ky person është përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës.

3. Oficeri Përgjegjës shqyrton çdo muaj llogaritë financiare të kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve të posaçëm dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerëve të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit si dhe të anëtarëve të afërt të familjeve të tyre.

4. Oficeri Përgjegjës ka akses tek deklaratimet e pasurive dhe të lidhjeve, të bëra prej kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve të posaçëm dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, oficerëve të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ai ka edhe bashkëpunimin e Shërbimit Informativ Shtetëror.

5. Nëse Oficeri Përgjegjës ka dyshim të arsyeshëm për sa më poshtë, ai ia raporton atë një prokurori të Prokurorisë së Posaçme, i cili nuk është i përfshirë në shkelje:
- a. transaksione të mëdha financiare;
  - b. modele të pazakonta transaksionesh financiare;
  - c. transaksione financiare nga burime të pazakonta apo kriminale;
  - ç. ekzistencë llogarish financiare të cilat nuk janë deklaruar.

### **Neni 56**

#### **Kontrollet dhe vëzhgimet që kryhen nga Byroja Kombëtare e Hetimit**

1. Oficeri Përgjegjës në Byronë Kombëtare të Hetimit krijon një plan për shqyrtimin çdo muaj të komunikimeve telefonike, mesazheve apo postës elektronike të kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, dhe të drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ky plan nuk u bëhet i ditur kryetarëve të gjykatave, gjyqtarëve, drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, prokurorëve të posaçëm, drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit apo kujtdo tjetër. Plani ndryshohet çdo tre muaj.
2. Oficeri Përgjegjës ka akses në deklarimet e pasurive dhe të lidhjeve, të bëra prej kryetarëve, gjyqtarëve dhe punonjësve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtuesit, prokurorëve dhe punonjësve të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Ai ka edhe bashkëpunimin e Shërbimit Informativ Shtetëror.
3. Nëse Oficeri Përgjegjës ka dyshim të arsyeshëm se një telefonatë, mesazh apo komunikim me postë elektronike është provë e korrupsionit, nxjerrjes së informacionit, komunikimit me organizata kriminale, ndikimit politik apo çfarëdo veprimi tjetër që mund të jetë në shkelje të Kodit Penal, ai ia raporton atë një prokurori të posaçëm të Prokurorisë së Posaçme, i cili nuk është i përfshirë në shkelje.
4. Oficeri Përgjegjës i ruan të dhënat për 2 muaj dhe, në rast se nuk urdhërohet nga një prokuror i Prokurorisë së Posaçme t'i ruajë të dhënat për më gjatë, i shkatërron ato pas muajit të dytë. Ky person është përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës.
5. Oficeri Përgjegjës nuk dëgjon telefonatat që shkelin të drejtën për jetë private të personave që nuk kanë dhënë miratim paraprak për vëzhgimin. Nëse Oficeri Përgjegjës ka dyshim të arsyeshëm se ka ndodhur apo do të ndodhë një veepër penale dhe se vëzhgimi i asaj telefonate me persona që nuk kanë dhënë miratim paraprak do të japë prova për këtë veepër penale, ai do të kontaktojë menjëherë një prokuror të posaçëm të papërfshirë në shkelje për të marrë autorizim nga gjyqkarta.

**Neni 57**  
**Mbrojtja e të dhënave**

Të dhënat personale mbahen në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**Neni 58**  
**Raportimi i informacionit dhe provave tek një prokuror jo i përfshirë i Prokurorisë së Posaçme**

1. Çdo person, përfshirë oficerët përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, kanë të drejtën të raportojnë informacion apo prova të një shkeljeje të kryer nga një kryetar ose gjyqtar i gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, prokuror i Prokurorisë së Posaçme, drejtor, zëvendësdrejtor, hetues, oficer i shërbimeve të policisë gjyqësore ose pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit, ose nga një punonjës tek një prokuror i Prokurorisë së Posaçme i cili nuk është i përfshirë në shkelje.
2. Bazuar në një raport në përputhje me paragrafin 1, një prokuror i Prokurorisë së Posaçme nis një hetim kundër kryetarit ose secilit gjyqtar të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, drejtuesit ose prokurori të Prokurorisë së Posaçme, drejtorit, zëvendësdrejtorit, hetuesve, oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore dhe pozicioneve të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimit, ose punonjësve, pa kërkuar miratim nga ndonjë autoritet tjetër.

**Neni 59**  
**Shkarkimi për shkeljen e kushteve të besimit dhe konfidencialitetit**

1. Nëse ka prova se një kryetar apo një gjyqtar i gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, një drejtues apo prokuror i Prokurorisë së Posaçme ka nxjerrë informacion sensitiv, qoftë nga pakujdesia apo me qëllim, ai person mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
2. Nëse ka prova se një punonjës i gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokurorisë së Posaçme, apo Drejtori, zëvendësdrejtori, hetuesit, oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore apo punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit ka nxjerrë informacion sensitiv, qoftë nga pakujdesia apo me qëllim, ai person mund të shkarkohet.

**KREU IX**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Neni 60**  
**Buxheti fillestar**

Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kanë buxhete fillestare të përcaktuar me vendim të

Këshillit të Ministrave dhe të miratuar me ligj të posaçëm për buxhetin. Të gjithë buxhetet e mëvonshëm përcaktohen në përputhje me këtë ligj.

## **Neni 61**

### **Dispozita kalimtare**

1. Dispozitat tranzitore për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda parashikohen në Nenin 167 të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
2. Dispozitat tranzitore për Prokurorët e Prokurorisë Për Krimet e Rënda parashikohen në Nenin 168 të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
3. Gjykatat kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar dhe Prokuroria e Posaçme vendosen në ndërtesën aktuale të Gjykatës për Krimet e Rënda dhe Prokurorisë për Krimet e Rënda.
4. Brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, do të jetë siguruar dhe pajisur një ambient i përshtatshëm pune për Byronë Kombëtare të Hetimit.
5. Në mënyrë që të respektohet e drejta e të pandehurve për një gjykim të drejtë, çështjet që do të jenë në gjykim para gjykatave për krimet e rënda në ditën e 300-të pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbeten nën kompetencën e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar, edhe nëse ato nuk bëjnë pjesë në kompetencën parësore apo dytësore të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar sipas këtij ligji. Këto çështje ndiqen penalisht nga Prokuroria e Posaçme.
6. në mesnatën e ditës së 300<sup>-të</sup> pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kompetencat e parashikuara nga Nenet 10 dhe 11 u kalojnë gjykatave kundër korrupsionit dhe krimet të organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme.
7. Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda, Nr. 9110, shfuqizohet në mesnatën e ditës së 300<sup>të</sup> pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.